



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

KËRKESË PËR OFERTË PËR KOMPANI AUDITUESE

Data e kërkesës:	3 Gusht 2022
Data e perfundimit:	16 Gusht 2022
Objekti i kërkesës:	Realizimi i Verifikimit të shpenzimeve të projektit ” I participate! My voice, my vote counts”/ 2019/414-176
Autoriteti Kontraktues:	Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Komiteti Shqiptar i Helsinkit është organizatë jofitimprurëse, në formën e shoqatës me anëtarësi. Është regjistruar fillimisht pranë Ministrisë së Drejtësisë, me urdhrin nr. 17/1 dhe më pas pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, sipas ligjit “Për organizatat jofitimprurëse” me vendimin nr.2/1, datë 19.07.2002.

Komiteti Shqiptar i Helsinkit kërkon të kontraktojë një Kompani Auditimi për Vlerësimin dhe Verifikimin e shpenzimeve në kuadër të projektit të zbatuar nga një konsorcium organizatash, në drejtimin e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, me titullin “Unë marr pjesë! Zëri im, vota ime vlen” financuar nga Bashkimi Evropian në vlerën 302,967.97 Eur.

Vlerësimi dhe verifikimi i shpenzimeve të këtij projekti do të realizohet, konform termave të referencës të percaktuara në Rregullat e PRAG për auditimin e kontratave të granteve të financuara nga BE.

Shërbimi i kërkuar do të realizohet nga Kompania fituese, përgjatë periudhës 1-13 Shtator 2022. Brenda kësaj periudhe, Kompania do të finalizojë dhe dërgojë pranë KSHH-së raportin përfundimtar për vlerësimin dhe verifikimin e shpenzimeve të projektit, të hartuar në përputhje me rregullat e PRAG-ut.

Në përzgjedhjen e aplikantit fitues, Komiteti Shqiptar i Helsinkit do të mbajë në konsideratë kriteret vijuese për të cilat duhet depozituar dokumentacion mbështetës:

- Liçencën e auditimit dhe përvojën së paku 5 vite në këtë fushë (Licencë dhe CV e kompanisë përfshirë kualifikimet përkatëse);
- Anëtarësinë ose Afilacionin në organizata apo kompani globale, në fushën e auditimit.
- Përvojat e ngjashme në auditimin e projekteve të mbështetura financiarisht nga Bashkimi Evropian dhe donatorë të tjerë (Listë me projekte të mëparshme të audituara, duke specifikuar vlerën e projektit, donatorin dhe organizatën implementuese).

Për të aplikuar, dergoni ofertën tuaj financiare dhe dokumentacionin shoqërues, deri më datë 16 Gusht 2022, në adresën office@ahc.org.al.

Fondi limit në dispozicion për këtë angazhim është 3,000 Eur, përfshirë TVSH.

Kontrata me Kompaninë e përzgjedhur si fituese pas përfundimit të procedurës së prokurimit



KOMITETI SHQIPTAR I HELSINKIT ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE

pritet të lidhet në datën 23 Gusht 2022.

**Me konsideratë,
Komiteti Shqiptar i Helsinkit**